



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "POSITIVE GOLD"
Nr. i biznesit 70692031
Pronare - Mrika KOTORRI
OSHMA TRAVELISTA TV
Rr/ Holger Pedersen II/1,
Lagjja e Spitalit
Prishtinë

Ref: 1710/1211/LIC/ni

VENDIM

për ndryshim të emrit të OSHMA Travelista TV në Travelingo TV

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Travelista TV është Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual, i licencuar për transmetim të programit përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë. Vendimi për licencimin e OSHMA Travelista TV është lëshuar nga ana e KPM-së, më datën 26 shtator 2017.
3. Më datën 17 tetor 2017, pronarja e OSHMA Travelista TV ka parashtruar një kërkesë me shkrim, duke kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit në "Travelingo TV".

Arsyetimi

4. Komisioni konsideron se, arsyeja e parashtrimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të OSHMA Travelista TV, është shmangja e komplikimeve të mundshme ligjore, për arsye të ekzistencës të një kanali në tregun ndërkombëtarë me të njëjtin emër, e që mund të jetë pjesë e katalogut të ndonjë operatori të shpërndarjes që ofron shërbime në Republikë e Kosovës.
5. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, KPM – 2017/02, respektivisht Neni 21, paragrafi 7, thekson: "*I Licencuari duhet ta identifikojë*

përmbajtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraparak nga KPM-ja.”


6. Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim “Travelingo TV”, nuk është i ngjajshëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe si i tillë, gjatë përdorimit të tij për identifikim, nuk do të shkaktoj konfuzion tek shikuesit, prandaj, kërkesa për ndryshim të emrit nga Travelista TV në Travelingo TV i plotëson kriteret për miratim.
7. Komisioni konsideron se, kërkesa e OSHMA Travelista TV për ndryshim të emrit është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

Vendim

8. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 1 nëntor 2017, mer vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të OSHMA Travelista TV në TRAVELINGO TV.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



08. 11. 2017

datë